




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep. <u>2-D</u> Nr. i taq. Ibroj, Stranica Nr. pages	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. <u>01-5130/11/a</u> Data Datum <u>29.12.2011</u> Date PRISTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.12.2011, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK– 01-3481/11, për **z. Haqif Mulliqi** - Prodekan, i Fakultetit të Arteve, Universiteti i Prishtinës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti me nr. AKK–01-3481/11, është trajtuar nën dyshimin e bazuar për Konflikt të mundshëm të Interesit, me veprimet e nevojshme të parapara sipas (Ligjit Nr.04/L-051), dhe atyre procedurale sipas (nenit 18.1 të këtij Ligji).

Pas identifikimit të rastit të ardhur në Agjenci në mënyrë anonime me dyshimin për ekzistimin e konfliktit të interesit të zyrtarit z. Haqif Mulliqi – Prodekan i Fakultetit të Artëve në Universitetin e Prishtinës, krahas ushtrimit të pozitave në Ministrinë e Kulturës Rinis dhe Sporteve si dhe në Radio Televizionin e Kosovës, kemi filluar procedurat për të kompletuar dokumentacionin nga këto institucione për të vertetuar se a ka gjendje të konfliktit të interesit apo jo.

Agjencia kundër Korrupsionit gjatë kësaj periudhe me veprimet e saj ka analizuar me kujdesë këto dokumentacione dhe ka ardhur në konstatim se z. Haqif Mulliqi – Prodekan i Fakultetit të Artëve në Universitetin e Prishtinës, në të njëjtë kohë ushtron edhe pozitën e këshilltarit politik në Ministrinë e Kulturës Rinis dhe Sporteve por paguhet sipas normës të paraparë me 50% , si dhe ka kontratë mbi veprën Autorjale me Radio Televizionin e Kosovës të lejuar sipas nenit 10 pika 3 të Ligjit Nr.04/L-051- Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj bazuar ne veprimet e mësipërme u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

